

KËRKIME GJUHËSORE

Durim ÇAÇA

DEIKTIKËT MITOLOGJIKË DHE AKTUALIZUES NË TRAGJEDINË “AKILI”

Vepra letrare e Et'hem Haxhiademit, e krijuar në vitet '20-'30 të shekullit të 20-të, paraqitet me interes edhe nga këndvështrimi gjuhësor pragmatik. Duke qenë krijimtari dramatike e zhanrit të tragjedisë, ajo paraqitet si arritja më e lartë e zhvillimit të këtij lloji letrar në letërsinë shqipe. Ushqyer me ideale kulturore dhe atdhetare të kohës së mendimit të ri intelektual të neoshqiptarizmit, të vlerës së familjes, si themel i kombit, etj., si dhe nga kultura klasike greko-romake dhe filologjia neoklasiciste e kulturës gjermane, gjatë viteve të studimeve të tij universitare në Vjenë dhe Berlin, E. Haxhiademi paraqitet si autor me një akti të ri ligjërimit estetik, me veçanësi të dallueshme, jo vetëm për kohën e vet, por dhe sot, pas afro një shekulli të krijimit të kësaj vepre artistike.

Si pararendje e fatit të tij tragjik (ai u dënua me vdekje, që iu kthye në burgim të përjetshëm, nga regjimi komunist i kohës dhe vdiq në burgun politik të këtij regjimit politik), Haxhiademi projektoi tragjedi me një madhështi heroike, të një ligjërimi të ngritur dhe të një fjalësimi sublim.

Një tekst të foluri (gojor a i shkruar) nuk është thjesht një bashkim thëniesh, sekuencash bisedore, por “është një thurje, me situatat dhe kushtet societale, me shumë rrafshë kuptimore, një mpleksje të shumë fijeve, e ngjashme me atë të një pëlhure tekstile, pra një teksturë”¹.

Fjalësimi i botës përmes përshkrimit dhe rrëfimit të saj, realizohet në tragjedinë “Akili” përmes një forme poetike gjuhësimi të lartë, në përshtatje me heronjtë mitologjikë, të zbritur nga madhështia mitike e fuqisë dhe përjetësisë hyjnore (Akili, Priami, Paridi, Polikseni, protagonistët e veprës dramatike në fjalë), në terrenin real të dramës së përditshme njerëzore. Autori fjalëson botën, përshtat përshkrimin e tij, me botën antike, por dhe me botën morale aktuale të kohës së vet. Ai e arrin këtë fjalësim, përmes rrëfimit jo të të gjithë mitit për heroin homerik, por vetëm të episodit tragjik, të vrasjes me pabesi të Akilit. Autori, brenda atmosferës mitologjike dhe përmes frymës heroike të asaj bote (përmes intertekstit, kujtimeve, referimeve, presupozimit të ngjarjeve dhe të bëmave të mëparshme të heronjve), krijon një lloj interpretimi të mitit, një tekst të ri, të imagjinatës dhe strategjisë së tij të komunikimit estetik, nëpërmjet kësaj vepre dramatike.

Kompozimi dialogjik i tekstit dramatik² nuk është vetëm i natyrës artistike të kësaj gjinie letrare. Mimetisi (imitimi) i dialogimit të individëve njerëzorë deri në një dialogjizëm kundërshtie e konfliktualiteti, të ngjashëm me atë

¹ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës*, Tiranë, 2010, f. 173.

² Kujtojmë, me këtë rast, se teksti dramatik nuk është i njëjtë me tekstin teatror, se i pari ka si mjet shprehës vetëm fjalën e shkruar, kurse i dyti ka dhe elementë të tjerë shprehës: aktrimin, skenografinë, etj.

DURIM ÇAÇA

dramacitet që përfton ky ndërveprim gjuhësor në situatën e vërtetë reale të aktit bisedor, është dhe modelim, rikrijim, inskenim diskursi, ngjarjeje dhe shpërfaqjeje ligjërimore. Si dialogjizmin ndërveprues, (ligjërimin e hapur, të mirëfilltë të interlokutorëve bashkëbisedues, të personazheve në skenën e konfliktit dramatik), ashtu dhe dialogjizmin e brendshëm monologjik, i gjejmë në të gjithë strukturën thurëse të tragjedisë në shqyrtim:

Priami: Parid, dashnij' e madhe ty t'verbon, / Prandaj ndëgjo t'yt at si t'këshillon

Ajo e huej asht, nuk i zihet besë / Dhe ti kët' luftë merr për shembëllesë; /...Paridi: Ç'ligjron me muë ti kshtu, o mbret Priam? / M'zemrove tepër, ndonse at të kam, /...³.

Akili: O ti hyjnesh' e dashunis s'bekueme. / O Afërdit', sa zjarr të madh më dhe! / Por ah, si zemrën t'ime të përvlueme / Të thyeme fare dhe pa shpres' e pe, /⁴.

Në analizën pragmatike edhe të një bisede fiksionale (të një dialogimi dramatik imagjinativ), një vend me rëndësi zënë elementët deiktikë⁵, - siç janë dëftimi i personave (vetëve) bashkëbisedues dhe i roleve të tyre si pjesëmarrës në shkëmbimin gjuhësor; dëftimi shoqëror i statusit publik, familjar, fafësnor të ndërfaqësve në skenën bisedore; dëftimi i akteve të tyre ligjërimore paraprirëse, si kontekst ku vendoset dialogimi fiksional i situatës së aktualizuar ligjërimore; dëftimi i kohës dhe vendit të ndërveprimit gjuhësor të ligjëruësve interlokutorë, - të gjithë këta elementë, parë si një mimetis i një shtate reale të aktit bisedor. Sepse “dëftimi rrok marrëdhëniet ndërmjet strukturës së gjuhës dhe konteksteve në të cilat ajo përdoret. Teorikisht ai është një nga format e referimit”⁶. Vëmë në dukje, me këtë rast, se referimi, presupozimi dhe ngërthimi bisedor në tekstin dramatik janë elementë të kuptimit në nivelin më të thellë (të dytë, të tretë) të një teksti bisedor (shkrimor), gjatë ndërveprimit gjuhësor, përmes aktit pragmatik.

Le t'i shohim këta deiktikë (dëftues) ose indeksorë (sipas termit në filozofi), apo tregorë, (sipas termit të përdorur nga Rrokaj), duke i grupuar në dëftime të mitologjisë dhe dëftime të aktualizimit.

Në dëftuesit mitologjikë të vepra dramatike “Akili” vëmë re persona të personazheve pjesëmarrës, fjalëruës e veprues të miteve: Priamin, Paridin, Poliksenën, Akilin të cilët, në aktin e tyre bisedor dramatik, ndërveprojnë gjuhësisht me “zërat” e tyre ligjërimorë, sipas cilësimeve të tyre, me të cilat thirren dhe i drejtohen njëri-tjetrit, si dhe të strategjive të tyre të ndryshme të komunikimit, përgjatë dialogimit dinamik.

Priami: Urdhno ktu pran, o bir i Thesalis, / Se ty të pret si dhanrrin e shtëpis / Nashti Priami dhe n'vënd t'birit t'ka; / Prandaj dëshronte sot për me të pa

³ E. Haxhiademi, *Vepra*, 1, Prishtinë, 2000, f. 89-90, 127.

⁴ E. Haxhiademi, *Vepra*, 1, Prishtinë, 2000, f. 89-90, 127.

⁵ Nga greq. Deixis të dëftesh me dorë.

⁶ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005, f. 307.

/...Urdhno pra rri, në nj'an' t'yt vjhërr ke, / Mbë tjetrën an' Paridin n'mosh'n e re / Paridin t'yt kunat e djalin t'im / I cili Trojës s'on' i suëll rrenim/...⁷.

Akili: O mbret me fam' i Trojës, un për nder/ e quj qi të më preç ti muë kët herë / Me buz' të qeshum dhe me fjal' miqsije / Ashtu si kunorës s'ate i kahije. / Deri nashtilufuëm me të vërtetë, Por mbaskëndaj na do të rrijm' të qetë/...⁸.

Në citimin më sipër ne dallojmë dhe dëftuesit e kohës, ku shohim jo vetëm kohën historike, por dhe kohën e brendshme narrative (kohën psikologjike), përmes modeleve të përfytyrara mendësie e fjalësimi të Greqisë antike, si dhe kohën e aktualizuar fizike, të shprehur me ndajfolje dhe shprehje ndajfoljore kohore dhe foljeve të kohës së tashme. Po kështu dallojmë dhe dëftuesit e vendit, ku vendoset situata e ndërveprimit gjuhësor dinamik dhe ku realizohet akti bisedor estetik, të cilët, përmes ndajfoljeve dhe shprehjeve ndajfoljore vendore, si dhe foljeve të kohës së tashme që tregojnë lëvizje në hapësirë konkrete, Trojën homerike.

Dëftuesit që tregojnë akte ligjërimore paraprirëse (kontekstuale), ku vendoset situata bisedore e aktualizuar, janë episodet periferikë të mitit trojan, që plotësojnë me kontekstin e tyre aktualizimin bisedor dramatik. Po kështu dëftuesit shoqëror të statusit publik, hierarkik, familjar të personazheve pjesëmarrës bashkëligjërues që, gjithashtu shfaqen përmes aktualizimit fiksional:

Priami: Ja, bij, yt shoq na pret, u qelle mjaft/ Dhe nusen ktu ta pruna djal' i aftë...

Akili: Si ty t'pëlqej do t'bajm, o mbret hyjnorë;⁹.

Dëftuesit aktualizues, veç mjeteve gjuhësore që përmendëm më lart, (ndajfoljet dhe shprehjet ndajfoljore të kohës dhe vendit, koha e së tashmes të formave foljore), në një shikim intertekstual, të aktit ligjërimor të komunikimit të tragjedianit me lexuesit, “kënduesit e ndershëm”, siç i quan ai në parathënien paraqitëse të veprës dramatike në fjalë, me bashkëkohësit dhe bashkëkombasit e tij (tragjedia “Akili” u shkrua në Vjenë), të viteve të 20-të të shekullit të 20-të, mund t'i shohim këta tregorë të aktualizimit, në shumë elementë të tjerë, si: në ideolektin e të folmes gegërishte të Elbasanit, në traditat popullore të trevës në fjalë, në sintema morale me vlerë të gjithëkohshme, në shoqërinë shqiptare të kohës ku krimet politike për hakmarrje sundim e pushtet mbulohen me fjalësimin e lartë atdhetar e kombëtar, që përkojnë me vrasjet politike, të fshehura me tirada patriotike:

Priami (Poliksenës): Mendo ahëre vetëm Trojën t'onë / Qi ka për me shpëtumun për gjithmonë / Se ti po t'bahesh gruj' e t'bir't t'Peleut, Ai ma s'do t'luftoj' kundër atdheut /...¹⁰

Veçori e tekstit dramatik është paraqitja e tij si një tekst i aktit të të folurit bisedor, të një bisede fiksionare estetike. Ndaj dhe në veprën që shqyrtojmë autori përshkruan dhe rrëfen një kohë të largët antike, me një gjuhë të përpunuar poetike

⁷ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 121, 122, 128.

⁸ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 121, 122, 128.

⁹ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 121, 122, 128.

¹⁰ E. Haxhiadem, *Vep. e cit.*, f. 96.

të letrarishtes dhe të të folmes së elbasanishtes së kohës së vet të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të 20-të. Kjo arrihet prej tij përmes konceptimit të tragjedisë letrare, si strukturë gjuhësore artistike, si dhe përmes protagonistëve të veprës në fjalë, të cilët, gjithashtu, përshkruajnë dhe rrëfejnë bëma dhe histori, qëndrime dhe sjellje fjalësore të botës dhe të marrëdhënieve e kumtimeve të tyre të mëparshme, për të argumentuar, mbështetur, bindur apo përligjur qëndrime apo veprime të tyre morale aktuale. Këto akte të foluri të tyre janë sa të hapura, (të cilat janë të rreme, siç janë argumentet e mbretit Priam për të shpëtuar Trojën, duke folur “me zemër të hapur”, “me dhembshuri”, “me dashuri për të bijën”, “së cilës i do lumturinë”), aq dhe të fshehta (planit për hakmarrje ndaj Akilit, për bijtë e tij të vrarë, duke e futur në grackën e pabesisë heroin grek, përmes kurorëzimit të tij me martesë, me të bijën, Poliksenën të cilën Akili e dashuron). E gjithë kjo situatë dramatike është dhënë përmes një akti bisedor dinamik të Priamit, i cili, nga njëra anë kërkon të bindë, Paridin të dashuruar me Helenën, por jo trim, që të realizojë shpagimin ndaj kryetrimt të frikshëm, përmes të folurit atdhetar, por dhe përçmues, duke ia kujtuar gjithherë se ai ishte shkaktari i gjëmës për të vëllezërit e tij të sakrifikuar. Dhe në anën tjetër, Priami përdor strategjinë e atdhetarit, për të futur në grackë të bijën, që të kurorëzohet me Akilin, të dashuruar prej saj, por që Poliksena, për shkak të dhembjes për vëllezërit e vrarë nga Akili, nuk e çon në mendje të vërë kurorë me të. Pra, kemi dy strategji të ndryshme komunikimi, për të realizuar një qëllim të vetëm, hakmarrjen ndaj heroit grek. Në strategjinë e komunikimit të parë, synohet të arrihet qëllimi përmes prekjës në dhembshurinë birnore e poshtërimit të bashkëfolësit (Paridit), në strategjinë e komunikimit të dytë synohet të arrihet qëllimi, përmes ndjenjës së atdhetarisë dhe dashurisë e dhembshurisë prindërore (me Poliksenën), duke zotëruar kështu situatën bisedore të dilemave të bashkëbiseduesve të tij, në kontekstin historik dhe societal të kohës. E gjitha kjo, siç kemi vënë në dukje herë pas here, dhënë me një gjuhë sublime, me të cilën fjalësohet, përshkruhet dhe gjuhësohet bota e antikitetit dhe e kohës së vet të shekullit të 20-të, prej dramaturgut të shquar E. Haxhiademi:

Poliksena: Qëndro përpara meje n'kamb' o trim, / Jo tyk' u ulun para gjunit tim! / Ngreu, pra, o djal hyjnor, ngreu ma përpjetë, / Se t'mora vesh qi m'don me të vërtetë./...Akili: Oh, ç'gaz pa mas'! T'vërteta, moj kaprolle, / I pate t'gjitha fjalët qi më fole? / Mos fol aq ambël ma, sepse thërrime / Ma bane zemrën muë me kto fjalime / ...Poliksena: O djal i lemun preThetidës s'detit, / Ta ruësh ti zemrën duhet prej tërmetit / Të dashunis qi të ka kap me muë./..¹¹.

Strategjia e komunikimit sublim edhe në elementë të ligjërit hipokrit, lajkatar dhe të pabesisë paraqitet si mjeshtëri të foluri, si art gjuhësor pragmatik mashtrimi dhe krimi, që realizohet nga zotëruesi i aktit të bisedës, kur bashkëfolësi nuk është i përqendruar e i vëmendshëm, për të kapur, për të dalluar në ngërthimin bisedor, atë që nuk është e thënë, si qëllim i vërtetë, nga folësi kryesor strategjik dhe që, përkundrazi, mbulohet, fshihet përmes asaj që thuhet, gjoja si e vërtetë prej tij, por që si përmbajtje thënieje, është e rremë.

¹¹ E. Haxhiademi, *vep.e cit* f. 96.

Veç fjalësimit poetik, në strategjinë e komunikimit sublim, në këtë tragjedi, zë vend dhe ngërthimi bisedor dinamik (implikatura në bisedë, ajo që, qëllimisht, nuk artikulohet si thënie, por që është pikërisht qëllimi i thënies, i ligjërimit bisedor), siç përmendëm dhe më parë, përmes të cilit, nënkuptohet ky tekst i pashprehur i thënies.

Priami (Poliksenës): Mendo atëhere vetëm Trojën tonë / Qi ka për me shpëtumun për gjithmonë, / Se ti po t'bahesh gruj e t'bir't t' Peleut, / Ai ma s'do t'luftoj kundër atdheut, /

*Poliksena: Por un prej atit s'mundem me kuptumun / Si mundet me më dhan' muë ke ai, / Qi ma të shumtët djem ja ka varrumun / Edhe e ka lan' t'shkret' në pleqëni! / Kundrejt atij a ndoshta ka mendumun / T' banj' ndonj' gja mbështetasi ai ditzi?/...*¹²

*Priami (Akilit): Ma n'funt na vetëm mbetëm; pra un shtruë / Dëshroj me ty, o djal, me biseduë. / Anmik' i rrept ti muë ma par' më qe, / I dashtun si Paridi tash më je; / Dikur ta lusja vdekjen ty gjithnji. / Të rrojsh me Poliksenën duë nashti, / Se m'vdiq Hektori, ruajtës i atdheut, / Dhe n'vënd të tij kam djalin e Peleut.../...*¹³

*Akili: Mbretnesha s'ditka, m'thuë, qi t'bij'n marton? / Ky lajm, të drejtën t'themi, po m'idhnon!...*¹⁴

*Priami: Urdhno pra rri; në nj'an' t'yt vjehërr ke, / Mbë tjetrën an' Paridin n'mosh'n e re, / Paridin t'yt kunat e birin tim, / I cili Trojës son' i suëll rrenim. / Prej ktij kjo luft' e madhe na filloi, / Prej teje kjo, o djal, do të mbarojë...*¹⁵

Në sekuencat dialoguese të mësipërme dallohen sërish lehtë deiktikët (dëftuesit) e kohës, vendit, ata shoqërorë e familjarë të statusit të bashkëbiseduesve dhe të roleve pjesëmarrës të bashkëfolësve, duke e drejtuar (orientuar) qartësisht tekstin bisedor dhe ndërveprimin gjuhësor, te secili pjesëmarrës në aktin ligjërimit, te synimi pragmatik gjuhësor të tyre, drejt një komunikimi të realizuar plotësisht dhe marrëveshjesor mes bashkëligjëruesve. Kështu, përmes deiksëve (dëftuesve) mitologjikë ne shohim Mbretin Priam, në vargjet e parë poetikë, që i drejtohet vajzës së tij, me statusin dhe afërsinë e prindit (në numrin njëjës), në pallatin e Trojës, në vitin e fundit të luftës së saj me grekët, në kohën pas vrasjes së Hektorit, duke i kërkuar që të martohet me gjaksorin e bijve të tij, me qëllimin atdhetar për të shpëtuar Trojën e tyre, përmes krushqisë me armikun (duke kaluar komunikimin e tij, nga statusi atëror në atë të mbretit, i cili ka përgjegjësi për fatet e atdheut, përgjegjësi që duhet të jetë e kuptueshme dhe pragmatike, ajo që mund të duket e pamendueshme dhe e papranueshme, kur vlen për largimin prej atdheut të rreziqeve dhe armiqve). Përmes komunikimit të Priamit me Akilin (tashmë ai i drejtohet atij me statusin e dhëndrit, duke shkuar dhe më tej, duke e dashur po aq sa djalin e tij, Paridin e duke shkuar edhe më tej, duke e parë si djalë që ka zëvendësuar, Hektorin, djalin e tij të

¹² E. Haxhiademi, *vep. e cit.* f. 96.

¹³ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 124, 130, 121.

¹⁴ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 124, 130, 121.

¹⁵ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 124, 130, 121.

vrarë pikërisht nga Akili). Në aktin e të folurit monologjik (me veten) të Poliksenës, (që është strukturë po aq dialogjike edhe “biseda” me veten¹⁶ dhe jo vetëm për psikanalizë artistike të karaktereve dramatikë), kemi gjithashtu deiktikët (dëftyesit) apo tregorët¹⁷ përkatës që lidhen me situatën e shqetësimit në të cilën realizon këtë komunikim ligjërimor me veten, por dhe dëftyesin e ligjëratës, të referimit të saj, në ligjërimet paraprirëse, në këtë rast, të tekstit bisedor të mëparshëm më të atin, realizon këtë komunikim ligjërimor me veten, por dhe dëftyesin e ligjëratës, të referimit të saj, në ligjërimet paraprirëse, në këtë rast, të tekstit bisedor të mëparshëm më të atin.

Ndërsa deiktikët (dëftuesit) aktualizues, siç vumë në dukje më sipër, dallohen përmes analizash më të thella të strukturës së tekstit. Ata kanë të bëjnë me dëftyesit në procesin e komunikimit të autorit me lexuesin (me ç’status iu është drejtuar ai bashkëkohësve të vet, dhe me ç’status na “drejtohet” ai ne sot. Ç’vlerë, ç’status i japim ne atij dhe mesazhit që kumton; kuptohet që jo vetëm atë të shkrimtarit, por dhe të intelektualit, idealistit dhe humanistit të qytetarisë së kohës së vet, etj. Deiksët aktualizues, që janë kryesisht dëftyes të tekstit, janë të natyrës simbolike. Megjithatë dhe dëftyes të qartë aktualizues ne shohim në sekuencat me thënie të përgjithësuara, me vlerë përvoje e morale të gjithëkohëshme, që nuk lidhen drejt për drejt me kohezionin e bisedës, por me koherencën e saj, duke fuqizuar e plotësuar argumentin e thënieve aktuale të thelbit përmbajtësor të bashkëfjalërimit.

Akili: O mbret, sa nan’ e shkret’ hek për fëmin / Nuk hjek i ati kurr, por pasunin / Shikon ai t’i vejë mbar’ si duhet / Dhe lavdi për trimni të mos i shuhet. / Çdo nan’ gjithmon’ mundohet për fëmin / Me shpres’ qi do t’i shoh fatbardhësin /...

Thënie kjo në kontekstin bisedor të situatës konkrete: Sot pra qi mbretënëshës i martohet / E bija dhe qi zemra do t’i gzohe / Asaj, ti nuk po don me i kallxuë? / E mir’ kjo gja s’më duket fare muë; /...

Analiza e aspekteve tingullore, problemet e domethënies së saj në kuadër të poetikës si dhe lidhshmëria e tingullit dhe e domethënies në një tërësi të pandashme, -janë fazat më të rëndësishme të hulumtimeve formaliste, - sipas Roman Jakobson-it. Ku në fazën e tretë është përpunuar nocioni i dominantes, e cila është një komponent qendror i veprës artistike që “i orienton”, i përcakton dhe i shndërron komponentët e tjerë, duke garantuar tërësinë e strukturës së një vepre letrare dhe duke i dhënë asaj veçanësinë¹⁸.

Dhe elementi që i jep veçanësinë një lloji të caktuar të gjuhës, e dominon tërë strukturën e veprës artistike. Te tragjedia “Akili”, kemi vargun poetik të orientuar drejt dimensionit muzikor, si te arti romantik, ku dominantja 18 ishte muzika, si vlerë sipërane e artit. Domethënia e situatës, rrethanës, kontekstit tragjik, në të cilën zhvillohet akti bisedor (hakmarrja e Priamit për bijtë e vrarë, duke vrarë me pabesi Akilin, përmes shfrytëzimi me pragmatizëm, dashurinë e së

¹⁶ Bakhtin, sipas referimit nga K. Dibra dhe N. Varfi, *Gjuhësi teksti*, Tiranë, 2005, f. 154.

¹⁷ Sh. Rrokaj, *Vep. e cit.*, f. 205.

¹⁸ R. Jakobson, *Dominantja*, www.segur, e-letrat, Holandë, 2008.

bijës, për heroin e pathyeshëm grek), shkon nëpër rrjedhën e dialogjizmit estetik, me tensionin përmbajtësor të kumtit tragjik, gjatë ndërskëmbimit bisedor (me çiftet e thënieve të tyre) të protagonistëve, të cilët hyjnë në konflikt, si kontekst dhe realitet fizik e psikologjik, ashtu edhe në universin e ligjëratës, të ligjëritimit, të diskursit dramatik. Në këtë rast, përcaktimi i funksionit estetik si dominante e veprës, na mundëson që të dallojmë, - sipas Jakobsonit, - hierarkinë e funksioneve gjuhësore të ndryshme, në kuadër të kësaj veprë si: funksionin preferencial, funksionin ekspresiv, emotiv, etj. Në veprën në fjalë, funksioni estetik përfaqëson dominanten e mesazhit gjuhësor. Virtytet e heronjve klasikë, (në këtë rast të Priamit), nuk marrin parasysh ndjenjat njerëzore të bijve të tyre (dëshirës që kanë për të jetuar dashurinë e vet, pa u marrë me vrasje për hakmarrje: Paridi, Poliksenja). Mesazh gjuhësor i cili jepet përmes mjeteve të gjuhës ekspresive, që i nënshtrohet funksionit vendit të veprës, nën ndikimin e dominantes së saj: sublimes estetike të fjalësimit të autorit, në përshkrimin dhe paraqitjen e botës sonë. Fjalësim letrar, ku Haxhiademi përshtat fjalën, gjuhën, të folurin e tij individual, ligjëritimin e tij personal, idiolektin e tij artistik me botën mitike, duke realizuar komunikimin kumtues me bashkëkohësit e vet të kohës moderne:

Akili: Shtërgat' e luftës shkoi; për muë qetsija / E duhshme asht, se zemrën timet' shkrete / E ka pushtumun krejt ma dashunija, / Qi asht e idhët tepër në kët' jetë; /...O Afërdit', sa zjarr të madh më dhe! / Por ah, si zemrën time të përflueme / Të thyeme fare dhe pa shpres' e pe, /...¹⁹.

“Kështu teksti poetik është i frymëzuar me magji tingujsh, është pothuajse një kompozim muzikor: fjalët tërheqin vëmendjen për veçoritë e tyre fonike, tingëluese dhe lexuese ka kënaqësi edhe vetëm kur i shqipton e i thotë me zë të lartë”²⁰. Sepse ligjëritimi poetik vijon më shumë me asosacione të lira, me sekuenca imagjinare dhe melodike, se sa me sekuenca kohore apo logjike, nga që përshkrimi është gjithnjë shprehës e subjektiv. Dhe me këtë vepër letrare, “dramatisti i parë i madh shqiptar, ndërton strukturën dhe konvencën e dramës neoklasiciste në shqip, me harmoni të brendshme, gati me baraspeshë matematikore, modelet shkrimore universale”²¹.

¹⁹ E. Haxhiademi, *Vep. e cit.*, f. 127.

²⁰ K. Dibra, N. Varfi, *Vep. e cit.*, f. 106

²¹ Sabri Hamiti, *Poetika shqipe*, Tiranë, 2010, f. 152.